

raporti vjetor 2010



7 ■ Fjala e Drejtorit
të Përgjithshëm

8 ■ Aksionarët

10 ■ Këshilli
Drejtues

12 ■ Zhvillimet Kryesore
nga 2003 - 2010

16 ■ Arritjet e Vitit

18 ■ Zgjerimi
i Bankës

20 ■ Struktura

22 ■ Produktet
Kryesore

24 ■ Sponsorizime

30 ■ Adresat
e Bankës

26 ■ Marrëveshje
Institucionale

32 ■ Bankat
Korrespondente

28 ■ Objektivat

34 ■ Pasqyrat
Financiare

Ne patëm një rritje
impresionuese prej **43.26%**
të aseteve, numri i degëve të
Bankës shkoi në **41** dhe numri
i klientëve të cilëve Banka u
shërbeu u rrit në **125.737**

z. Artan SANTO

Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm z. Artan Santo

Viti 2010 tregoi pjekurinë tërësore të Credins Bank në një kohë ku ekonomia shqiptare ka pasur një nevojë të dukshme për mbështetje financiare. Sfidë jonë më e madhe ishte rritja e Bankës në të gjithë parametrat e saj, rritje kjo e realizuar në mënyrë të tillë që të balanconte përgjegjësitë tona përballë të gjitha grupeve të interesit.

Ne patëm një rritje impresionuese prej 43.26 % të asetëve, numri i degëve të Bankës shkoi në 41 dhe numri i klientëve të cilëve Banka u shërben u rrit në 125.737. Të gjithë këto tregues janë fryt i një pune të bashkërenduar mirë, falë një menaxhimi eficient të kapaciteteve njerëzore e financiare të Credins Bank si dhe të një vizioni koherent të Manaxhmentit të Lartë mbi zhvillimet e tregut.

Fokusi i punës së përditshme mbetet gjithmonë mbështetja e klientëve tanë në plotësimin e nevojave të tyre financiare. Ne e dimë që nevojat e tyre janë në ndryshim e kështu edhe ne përshtatemi bashkë me to, në të mirë të interesave tona të përbashkëta.

Bazuar në këtë logjikë, gjatë vitit 2010 ne vazhduam financimin e klientëve ekzistues por edhe të rinj të Bankës, nëpërmjet produkteve me gamë të gjerë dhe transparente. Portofoli i kredisë u rrit me rreth 34%, rritje kjo e cila i siguron Bankës një pozitë konkurruese në treg, por gjithashtu të kontrolluar dhe të përgjegjshme. Përgjatë viti 2010, ne ristrukturoam një pjesë të portofolit të kredisë, duke gjetur mënyrën më të mirë për të ndihmuar klientët tanë të tejkalonin vështirësitë dhe të plotësonin obligimet e tyre financiare.


Një vëmendje të veçantë i kushtuam edhe klientit individ. Zgjerimi i vazhdueshëm i kërkesave të tij na bëri më të vëmendshëm në maksimizimin e tyre. Ndër shumë produkte të reja të hedhura në treg, ai që ishte më i veçanti e emërtuam “Depozita Gold”, ku për të parën herë në tregun bankar vendas, tregtimi i arit krijon risi dhe individualitet të veçantë.

Sipas këndvështrimit tonë, dy fusha potenciale zhvillimi janë fusha e energjetikës dhe ajo e bujqësisë. Mendojmë se e ardhmja e vendit tonë do të tentojë drejt tyre, ndaj gjithnjë e më shumë financimet tona do të synojnë në këto drejtime.

Për sa i takon vitit 2011, ne do të gjenerojmë të tjera forca që kjo kompani e madhe që ne kemi krijuar, t’ju shërbejë sa më mirë klientëve, komunitetit dhe aksionarëve në arritjen e objektivave të tyre financiare. Synojmë më tepër zhvillim, më shumë klientë, shtrirje më të gjerë, ndihmesë më të madhe për ekonominë dhe biznesin shqiptar.

2011 do të jetë për Credins Bank, vit i lançimit të një game të gjerë produktesh, të para me një tjetër vizion, të modeluara sipas teknikave tona bankare, duke ndjekur ecurinë e kërkesave në rritje të klientëve, të cilat do të synohen të tregtohen në mënyrën më optimale, kudo ku Credins Bank është e pranishme me emrin e saj.

Ju përshëndes,
Artan Santo
Drejtor i Përgjithshëm





aksionarët

25.18% 22.17% 24.72%

z. Aleksandër PILO

Z. Aleksandër Pilo zotëron 25.18% të aksioneve të Credins Bank.

Z. Pilo është një prej iniciatorëve të themelimit të Credins Bank dhe Administratori i Shoqërisë Emigres Sh.p.k., një nga shoqëritë më të mëdha në vend për importimin, tregtimin e pllakave dhe pajisjeve arreduese hid ro-sanitare. “Emigres” ushtron aktivitetin e saj që nga viti 1992.


Fondi i Investimeve Financiare në Ballkan

Fondi i Investimeve Financiare në Ballkan (Balkan Financial Sector Equity Holding B.V. - BFSE Holding BV) Holandë zotëron 22.17% të aksioneve të Credins Bank.

Përfaqësohet nga Fondi i Zhvillimit Financiar (Development Financial Equity Partners) DFE. Fokusi i këtij Fondi është kryerja e investimeve private në kapitalin aksionar, në sektorin e shërbimeve financiare, veçanërisht në institucione financiare jo-banka dhe banka me kapital vendas. Ky fond mbështetet në politika, që synojnë në zhvillimin dhe financimin për sektorin Mikro dhe SME, të përqendruar kryesisht në rajonin e Evropës Juglindore.

z. Renis TËRSHANA

Z. Renis Tërshana zotëron 24.72% të aksioneve të Credins Bank. Ai administron kompaninë “R&T” Sh.p.k., kompani kjo e krijuar në 23 Nëntor të vitit 1995. “R&T” vepron në sektorin e tregtisë së artikujve të ndryshëm elektronikë dhe zhvillimit të paketave të software-ve, Punë Civile/ Shërbime inxhinierike, Telekomunikacion, duke ju përgjigjur një game të gjerë kërkesash të bizneseve vendase dhe ndërkombëtare.



14.15%

3.46%

3.17%

Menaxhimi i lartë

Tre Drejtuesit e Lartë të Credins Bank, z. Artan Santo (Drejtor i Përgjithshëm), znj. Monika Milo (zv. Drejtore e Përgjithshme) dhe z. Maltin Korkuti (zv. Drejtor i Përgjithshëm), zotërojnë 14.15% të aksioneve të Bankës.

Këta Drejtues, Aksionarë, me një background të gjerë drejtimi në sektorin bankar janë çelësi i suksesit të deritanishëm të Credins Bank. Pikërisht ky kombinim ka vepruar dhe si nxitës në sjelljen e risive në politika konkurruese në tregun bankar shqiptar, duke e pozicionuar Credins Bank si një nga Bankat më të suksesshme në treg.

Bushati shpk

Bushati Sh.p.k zotëron 3.46% të aksioneve të Credins Bank. Z. Bushati është Administrator i Kompanisë “Bushati” Sh.p.k. Kjo kompani është themeluar në Shkurt të vitit 1994 dhe ka hyrë tashmë në dhjetëvjeçarin e dytë të suksesit në fushën e ndërtimeve dhe rikonstruksioneve, duke krijuar një emër mjaft të mirë në treg.

SECO

Sekretariati Shtetëror i Marrëdhënieve Ekonomike (State Secretariat for Economic Affairs) SECO zotëron 3.17% të aksioneve të Credins Bank.

Kjo strukturë qeveritare e shtetit të Zvicrës është një ndër aksionarët më prestigjioz të Credins Bank. SECO është një agjenci zhvillimi e Qeverisë Zvicerane e vlerësuar me AAA, e cila ka ndërmarrë projekte zhvillimi shumë të rëndësishme. Qëllimi kryesor është zhvillimi i sektorit financiar, i cili ndihmon dhe zhvillon financimin e Biznesit të Mesëm dhe të Vogël. SECO përfaqësohet nga Fondi i Investimeve Zvicerane për Tregjet e Reja (Swiss Investment Fund for Emerging Markets) SIFEM AG.

këshilli drejtues

ILIRJAN BUSHATI

Kryetar

I diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Tiranë, në vitin 1978 dhe me një eksperiencë të gjatë në fushën e transporteve.

Z. Ilirjan sot është administrator dhe njëkohësisht aksionar i kompanisë "BUSHATI" Sh.p.k. Ai është një prej aksionarëve themelues të Institutit financiar "Credins".

MALTIN KORKUTI

Anëtar

Z. Korkuti është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Tiranë dhe atë të Universitetit të Vjenës, në profilin Financë. Zotëron Doktoraturë në profilin Financë dhe Kontabilitet. Aktualisht është zv. Drejtor i Përgjithshëm i Credins Bank dhe njëkohësisht një prej themeluesve të Institutit Credins dhe aksionar i Credins Bank.

CLIVE MOODY

Anëtar

I diplomuar në Kolegjin St.John's të Kambrixh, (MA në Gjeografi), sot z. Moody është Partner Manaxher, bashkëthemelues dhe aksionar i DFE Partners që menaxhon Fondin "Balkan Financial Sector Equity", aksionere e Credins Bank.

ELONA GJIK

Anëtare

Znj. Gjika është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës dhe atë të Barit, ajo është anëtare e ACCA (Association of Chartered Certified Accountants). Pas një eksperience disa vjeçare në pozicione drejtuese në KPMG Albania, ajo aktualisht është Menaxhere e Departamentit të Sigurisë dhe Cilësisë të të Ardhurave pranë operatorit celular, AMC.

MAKSIM HAXHIA

zv. Kryetar

Z. Haxhia është i diplomuar në Fakultetin Juridik dhe Shkencave Politike si dhe në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës dhe zotëron diplomën Master dhe Doktoraturë në profilin Juridik. Mban Titullin "Profesor i Asociuar". Aktualisht është Partner në Studion Ligjore Haxhia & Hajdari.

MONIKA MILO


Anëtare

E diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Tiranë. Znj. Milo, me eksperiencë të gjerë në sektorin bankar shqiptar, është një prej themeluesve të Institutit financiar Credins, ku dhe ka mbajtur për 2 vjet pozicionin e Drejtores Ekzekutive. Ajo është gjithashtu një prej themeluesve të Credins Bank, dhe njëkohësisht aksionare e saj. Aktualisht është zv. Drejtore e Përgjithshme e Credins Bank.

SAIMIR SALLAKU

Anëtar

Z. Sallaku është diplomuar në degën Financë-Kontabilitet në Universitetin e Tiranës dhe ka kryer studimet Master për Administrim Biznesi në Universitetin Staffordshire, UK. Nga 2005 e deri më sot ai është lektor në Universitetin e Tiranës në profilin Menaxhim Financiar. Gjithashtu ai është Koordinator për Shqipërinë për organizatën studentore SIFE- Albania.



TIME PLAN

BUSINESS STRATEGY → INNOVATION
GROWTH

BUSINESS PLAN ???

BUSINESS PLAN

IDEA

ANALYSIS

BUDGET

FINANCE

PROJECT!

TEAM

DEVELOP



EXECUTIVE

OUR MISSION
OUR VISION
OUR TARGETS

TEAMWORK

YES\$

ORGANIZATION

 HO 

TRAINING PROGRAM

- ✓ HUMAN RESOURCES
- ✓ BUSINESS ETIQUETTE
- ✓ CROSS CULTURAL
- ✓ MANAGEMENT
- ✓ LEADERSHIP
- ✓ PRESENTATION
- ✓ COMMUNICATION
- ✓ TIME MANAGEMENT
- ✓ CUSTOMER SERVICE

41
branches

zhvillimet kryesore nga 2003-2010

SHARE

%

B2B
SOLUTIONS

VAL

zhvillimet kryesore nga 2003-2010

'03

31 Mars **2003** Themelohet Credins Bank, e para bankë private me kapital 100% shqiptar. Slogani i Bankës është "Ne bëjmë më të mirën për ju, sepse flasim gjuhën tuaj".

12 Dhjetor **2003** Firmoset marrëveshja me UNOPS për programin PASARP, i cili ka si fokus kreditimin e SME-ve në fushën "Agrikulturë dhe Agro-Industriale", përmes zhvillimit, racionalizimit dhe përmirësimit të strukturave për prefekturat e Shkodrës, Durrësit dhe Vlorës.

1 Dhjetor **2003** Credins Bank nënshkruan me kompaninë American Express marrëveshjen e marketimit të kartave "American Express". Në bazë të kësaj marrëveshje Credins Bank lëshon 5 tipe karta pagesash të kësaj kompanie të cilat mund të përdoren në çdo vend të botës ku pranohet shërbimi "American Express".

'04

31 Dhjetor **2004** Credins Bank mbyll vitin 2004 me një të ardhur neto pozitive dhe projekton planet e saj drejt një rritjeje progresive në tregun bankar.

'05

20 Dhjetor **2005** Credins Bank nënshkruan marrëveshjen me Grupin e Monte Dei Paschi di Siena në Itali për kryerjen e transfertave bankare nga emigrantët me kosto minimale në Shqipëri, deri në 250 Euro falas.

'06

1 Shtator **2006** Ofrohet shërbimi bankar Credins Online, i cili mundëson veprime nga llogaria Bankare përmes internetit ose celularit.



'07

1 Qershor **2007** Credins Bank bëhet Principal Member i kartës Visa duke i mundësuar çdo klienti të saj shërbimet e kartës Visa kudo në botë.

31 Dhjetor **2007** Credins Bank rrit fitimin e saj vjetor me 132%. Rrjeti i saj i degëve dhe agjencive arrin në 21 duke ofruar një gamë të plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare.

'08

12 Janar **2008** Pjesëmarrja e dy fondeve të rëndësishme të huaja me kuota kapitalesh, si Fondi i Investimeve Financiare në Ballkan – Balkan Financial Sector Equity Holding B.V. (BFSE Holding B.V), Hollandë dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran i Marrëdhënieve Ekonomike – State Secretariat for Economic Affairs (SECO). Pas miratimit zyrtar nga Banka e Shqipërisë në fillim të vitit 2008, këto dy fonde zotërojnë tashmë 25.34 % të paketës së aksioneve të Credins Bank.

'09

27 Maj **2009** Nënshkrimi i marrëveshjes së Kredisë Kuadër me vlerë 7 milionë euro me European Fund for South East Europe (EFSE).

29 Qershor **2009** Credins Bank vlerësohet për treguesit e saj financiarë sipas indeksit të Moody's.

'10

Nderohet me çmimin "Banka më Inovative e Vitit".
Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit me Postën Shqiptare.
Credins Bank renditet e 5-ta bankë për nga treguesit financiar në gjithë sistemin bankar.


arritjet e vitit 2010

Rezultatet e arritura gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009:

Në '000 Lekë


43.26%

Totali i
aktiveve




35.04%

Portofoli
bruto i
kredisë



43.79%

Depozitat
e klientëve




27.18%


516

41


Fitimi neto



Numri i stafit



Numri i
degëve dhe
agjencie



zgjerimi i bankës

Gjatë vitit 2010 Credins Bank vazhdon dukshëm zgjerimin e saj të rrjetit të degëve dhe agjencive, duke inauguruar 6 degë të reja.

Në 2010, rrjeti i Credins Bank arriti numrin e **41 degëve dhe agjencive**. Duke mbuluar pothuajse

çdo qark të Shqipërisë, ne vijmë pranë klientit duke i krijuar lehtësira bankare çdo grupi të klientëve (individ /biznes i vogël/SME/Korporate/Institucion Publik), përmes ofrimit të një game të plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare, me një standard të lartë dhe kushte konkurruese.

DEGA TIRANA 14



Dega Tirana 14
Rr. Don Bosko

DEGA TIRANA 15



Dega Tirana 15
Pranë Ushtarit të Panjohur

DEGA BURREL



Dega Burrel
Lagjja Pjetër Budi

DEGA PESHKOPI



Dega Peshkopi
Bulevardi Elez Isufi

DEGA BALLSH




Dega Ballsh
Lagjja 5 Shkurti

DEGA BERAT



Dega Berat
Lagjja 22 Tetori


Vendndodhja jonë



Tiranë
Durrës
Kavajë
Lushnje
Fier
Vlorë
Elbasan
Korçë
Fushë-Krujë
Lezhë
Shkodër
Kukës
Burrel
Peshkopi
Berat

**Planet e zgjerimit të
Credins Bank vazhdojnë
dhe shumë shpejt do të jemi
të pranishëm në
Sarandë dhe Gjirokastër.**

struktura



Në një ambient rritjeje dhe ndryshimi të vazhdueshëm në të cilin Credins Bank zhvillon aktivitetin e saj, në funksion të dinamikës së progresit, u kthye në domosdoshmëri rishikimi dhe përmirësimi i strukturave të Bankës.

Në këtë kuadër nisi gjatë vitit 2010 dhe në vazhdim, krijimi i strukturave të reja të brendshme për të mbështetur sa më mirë arritjen e objektivave afatgjata të bankës, me synim jo vetëm rritjen e efektivitetit të aktivitetit të Bankës, por dhe krijimin e një ambienti dinamik dhe promovues për vetë stafin.


Më poshtë strukturat më të reja të familjes Credins:

DREJTORIA E ORGANIZIMIT

Misioni: Të mbështesë aktivitetet e ndryshme të Bankës duke përmirësuar proceset për një funksionim sa më eficient dhe efikas të tyre. Të asistojë njësitë përgjegjëse për realizimin e objektivave të biznesit dhe njësitë që kryejnë funksione operacionale në bankë. Të mbikëqyrë dhe përmirësojë vazhdimisht strukturën organizative të Bankës për të qenë në linjë me eksperiencat dhe praktikat më të mira Bankare.

DREJTORIA EKONOMIKE PRANË DEPARTAMENTIT TË LOGJISTIKËS

Misioni: Të sigurojë miradministrimin e buxhetit të Bankës për infrastrukturë dhe për shpenzimet operative duke realizuar optimizimin e kostove, miradministrimin e aseteve të Bankës, si dhe përmbushjen e nevojave të punonjësve duke iu përmbajtur buxhetit të parashikuar.



OFICERI I PËRPUTHSHMËRISË PRANË DEPARTAMENTIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Misioni: Të mbikqyrë veprimtarinë e Bankës në lidhje me kuadrin rregullativ të brendshëm dhe të jashtëm, duke vepruar si një trup i pavarur dhe objektiv, i cili rishikon dhe vlerëson çështjet e përputhshmërisë brenda organizatës.

DEPARTAMENTI I RIKUPERIMIT TË KREDIVE ME PROBLEME

Misioni i Departamentit të Rikuperimit të Kredive është të sigurojë ndjekjen dhe kthimin e kredive të cilat shfaqin probleme, duke angazhuar të gjitha mjetet në dispozicion për realizimin e kthimit të vlerës së tyre, me ndikim të drejtpërdrejtë në bilancin e Bankës. Gjithashtu, Departamenti i Rikuperimit përpilon strategjinë për ndjekjen e problematikës të secilës degë dhe segmenteve kredidhënëse, kontrollon zbatimin e procedurës nga stafi i Bankës.



DREJTORIA E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE, FINANCIMIT E TERRORIZMIT DHE PËRPUTHSHMËRISË LIGJORE

Misioni: Të sigurojë zhvillimin e aktivitetit të Bankës në përputhje me tërësinë e kuadrin rregullativ të brendshëm dhe të jashtëm dhe të sigurojë parandalimin e përdorimit të Bankës si rrugë për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

produkte të reja



Depozita GOLD

Investimi në monedha të çmuara dhe veçanërisht në ar mbetet prej shumë shekujsh një preferencë edhe sot. Ari është botërisht i njohur si mjet financiar i sigurt dhe si një ndër aktivet më likuide. Marrja e licencës së tregtimit të kësaj monedhe u dha mundësinë shumë klientëve të zgjerojnë gamën e investimeve dhe të mendojnë ndryshe për kursimet e tyre. Krijua Depozitën Gold.

Depozita Gold solli në treg një tjetër risi. Ajo krahas një norme interesi konkurruese ofron dhe një pllaketë ari. Kombinimi i këtyre dy elementeve për Credins Bank është një gjest mirënjohjeje ndaj besimit që klientët tanë na japin çdo ditë.



Depozita PLUS

Depozita Plus mbetet një ndër produktet më të veçanta të Credins Bank. Ajo u ofron mundësinë klientëve të depozitojnë shuma të caktuara çdo muaj dhe të marrin interesa të leverdishme. Oferta e një plani kursimi sistematik dhe të personalizuar, shtyu dhe këtë vit shumë klientë të kursejnë dhe të shohin frytet e kursimeve të tyre në interesa kreditore konkurruese në treg. Të shpenzosh para është e thjeshtë. Të kurseni, ju ndihmojmë Ne!

Paga CREDINS

Viti 2010 shënoi për Credins Bank një rritje të konsiderueshme të numrit të klientëve pagamarrës. Ndaj dhe Paketa PagaCredins u krijua në përputhje me nevojat e gjithsecilit dhe me kosto minimale. U erdhëm në ndihmë klientëve të menaxhojnë të ardhurat e tyre pa komisione llogarie dhe me interesa preferenciale në kredi dhe overdrafte.



Zhvillimi i kredisë MIKRO

Në vitin 2009 u krijua Departamenti i Mikrokredisë, duke i'u përgjigjur nevojës së tregut për produkte të reja dhe konkurruese. Sot jemi krenar për një rrjet kredidhënieje të shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe për mbulimin e nevojave për kredi të rreth 3000 bizneseve mikro. Produktet e Mikrokredisë jepen për disa nivele të caktuara shumë duke u përshtatur me kërkesat e klientit. Në fund të vitit 2010 portofoli i Mikrokredisë arriti vlerën 1,3 miliardë lekë, e cila krahasuar me vitin 2009 shënon një rritje prej 46% ndërsa numri i klientëve u rrit me 50%.



sponsorizimet 2010



Fondacioni "Shtëpia e Shpresës"



Teatri "Andon Zako Cajupi" Korçë



Fshati SOS, Tiranë

EDUKIMI I FËMIJËVE

Fëmijët janë e ardhmja jonë dhe ata meritojnë një të ardhme të lumtur. Nisur nga ky mision fisnik, Credins Bank ka sponsorizuar disa aktivitete si më poshtë:

Fondacioni "Domenick Scaglione"

15 Janar-2010 dhe 4 Tetor-2010

Mbështetje në dy aktivitete kulturore të organizuara nga Fondacioni "Domenick Scaglione". Këto kontribute bamirësie kaluan për finalizimin e Qendrës Kombëtare të Zhvillimit Mjekësor për Fëmijët. Misioni i Qendrës është të ofrojë për fëmijët dhe familjarët e tyre një kujdes terapeutik modern.

"Rinia Shkollore dhe Sipërmarrja Private"

Konkurs në Durrës, 29 Mars – 7 Prill 2010

Një tjetër sponsorizim për fëmijët, kësaj rradhe në përgatitjen e tyre ekonomike. Sponsorizimi u krye për të mbështetur organizimin e konkursit për nxënësit e shkollës "Marie Kaculini" të qytetit të Durrësit. Ky organizim i'u dha mundësinë nxënësve të thellonin njohuritë mbi aspekte të ndryshme të veprimtarisë bankare si dhe të përfshiheshin në përgatitjen e një reklame duke përdorur teknologjinë e sotme të informacionit.

Fondacioni "Shtëpia e Shpresës"

21 Dhjetor 2010

Sponsorizimi i organizimit të festës së fund vitit për fëmijët e këtij fondacioni si edhe për fëmijët e tjerë të cilët jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike, për t'u siguruar këtyre fëmijëve argëtim për festat e fund vitit.

Fshati SOS, Tiranë

21 Dhjetor 2010

Ky sponsorizim u krye për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve për lodrat e fëmijëve të Fshatit SOS me rastin e festave të fund vitit 2010.

AKTIVITETET KULTURORE

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

20-21-23-24-26 Mars 2010

Arti është një ndër burimet kryesore të ushqimit shpirtëror të një shoqërie. Edhe në 2010, fokusi i Credins Bank ishte mbështetja brenda buxhetit të planifikuar marketing të aktiviteteve kulturore. Në këtë kuadër kemi mbështetur Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor duke sponsorizuar hedhje në skenë e operës "Rigoletto" në muajin Mars.



Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor



Kryqi i Kuq Tiranë



"Rinia Shkollore dhe Sipërmarrja Private", konkursi Durrës

Teatri "Andon Zako Çajupi". Korçë 12 Nëntor 2010

Sponsorizimi i koktejlit dhe aktivitetit që u organizua me rastin e 60 vjetorit të krijimit të teatrit "Andon Zako Çajupi" dhe të 50 vjetorit të estradës së Korçës. Në këtë aktivitet u shpërndanë një sërë titujsh të lartë. I ftuar nderi ishte edhe Presidenti i Republikës Z. Topi.

Recitali "Una Serenata Romana" nga Tenori Kastriot Tusha Korrik 2010

Sponsorizimi u krye për ti dhënë një shtysë më të madhe zhvillimit të turizmit kulturor dhe për të gjallëruar jetën artistike. Recitali u mbajt në amfiteatrin e qytetit të Durrësit për promovimin e vlerave historike, arkeologjike dhe kulturore të perlave të vendit tonë.

AKTIVITETE HUMANITARE

Kryqi i Kuq Tiranë 16-19 Shtator 2010

Sponsorizimi u krye me qëllim realizimin e aktivitetit "Konkursi Ballkanik i Ndhmës së Parë" organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar dega Tiranë më datë 16-19 Shtator 2010. Ky organizim pati pjesëmarrjen e 10 shteteve të cilat u përfaqësuan nga personalitetet e tyre dhe nga të rinjtë konkurrues.

AKTIVITETE EKONOMIKE

Fushata marketing e titulluar "Welcome to Durrës Region". Prefektura e Qarkut Durrës 8 Qershor-2010

Promovimi i vlerave turistike të Shqipërisë. Ky ishte qëllimi i sponsorizimit të fushatës marketing të organizuar nga Prefektura e Qarkut Durrës në lidhje me projektin e titulluar "Welcome to Durrës Region". Ky projekt kishte si qëllim promovimin e vlerave arkeologjike, historike dhe turistike të territorit gjeografik që mbulon kjo prefekturë (Durrës dhe Krujë).

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë 28 Nëntor-2010.

Sponsorizimi i eventit që u organizua në Bruksel me rastin e Liberalizimit të vizave për qytetarët shqiptarë, ku Ambasada e Republikës së Shqipërisë mbledhi në këtë pritje përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të BE.

marrëveshjet institucionale



Building together a sustainable credit scheme
for the provision of financial support to local entrepreneurs.

Së bashku, në ndërtimin e mekanizmave kreditues
për ofrimin e mbështetjes financiare ndaj sipërmarrësve lokal.

MARRËVESHJA ME UNOPS-in

Në datën 28 Shtator u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Credins Bank dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime dhe Projekte (UNOPS) për ndërtimin e mekanizmave kreditues që ofrojnë mbështetje financiare për biznesin e vogël dhe të mesëm.

Kjo marrëveshje, e cila mbështetet në bashkëpunimin e filluar mes institucioneve që në Dhjetor të vitit 2003, u nënshkrua nga z. Artan Santo, Drejtor i Përgjithshëm i Credins Bank dhe z. Luigi Cafiero përfaqësues i UNOPS-it.

Marrëveshja me UNOPS-in është një tregues pozitiv i krijimit të mekanizmit financiar, fondit të garancisë, vënë në dispozicion nga Qeveria Italiane nëpërmjet Cooperazione Italiana. Ky fond i mundëson Credins Bank financimin e segmentit të bizneseve mikro dhe SME, të cilat edhe pse kanë aftësi paguese të mjaftueshme në shlyerjen e kredisë, nuk kanë garancitë dhe kolateralët e mjaftueshme për të përfituar atë.

Nëpërmjet financimit të këtyre bizneseve, do të kontribuohet në zhvillimin e situatës ekonomike të zonave lokale ku këto biznese operojnë, më konkretisht në Shkodër dhe në Vlorë, ku UNOPS-i ka çelur në Shqipëri, Agjencitë Lokale të Zhvillimit Ekonomik (Local Economic Development Agencies - LEDAs), për të realizuar objektivat e vendosura. Dy nga këto Agjenci, "TEULEDA" në Shkodër, dhe "AULEDA" në Vlorë do të menaxhojnë dhe do të identifikojnë klientët potenciale që mund të përfitojnë nga ky program.

Nënshkruhet
marrëveshja e bashkëpunimit
midis Credins Bank dhe
Zyrës së Kombeve
të Bashkuara për Shërbime
dhe Projekte (UNOPS)

PROJEKTI ME POSTËN SHQIPTARE



Në kuadrin e zgjerimit të bashkëpunimit disavjeçar midis Credins Bank dhe Postës Shqiptare, në Dhjetor të 2010 nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit financiar me objekt ofrimin e disa shërbimeve bankare përmes filialeve të Postës. Ky është një nga projektet më të rëndësishme të nisura në vitin 2010, pasi Marrëveshja e nënshkruar mes Postës Shqiptare dhe Credins Bank mundëson shfrytëzimin e një numri të konsiderueshëm të filialeve postare si degë të bankës, fillimisht me financimin me kredi konsumatore të klientëve në të gjithë Shqipërinë dhe më pas, me krijimin e hapësirave të bashkëpunimit për të ofruar më shumë produkte e shërbime të tjera në të ardhmen.

Qëllimi është të zgjerohet aktiviteti i të dyja palëve pjesëmarrëse, fuqizimi i pranisë së tyre në tregun e shërbimeve dhe produkteve dhe më kryesorja, plotësimi i kërkesave të klientit.

Credins Bank nëpërmjet bashkëpunimit me Postën Shqiptare ofron shërbimet e saj financiare në çdo shtëpi shqiptare edhe në zona ku ajo nuk është e pranishme me degë, duke shënuar në këtë mënyrë një reformë në cilësinë e shërbimit për nga shtrirja dhe shpejtësia, pasi çdo kërkesë e Klientit nis dhe plotësohet në sportelin e Postës.

Si hap i parë i këtij projekti bashkëpunimi u përcaktua ofrimi i produkteve kredi të shpejta, në kuadër të fushatës kombëtare "Shqipëria në moshën e Internetit".

Kjo kredi është forma më përfaqësuese e bashkëpunimit Postë Shqiptare-Credins Bank, edhe në serinë e projekteve të Qeverisë Shqiptare që synojnë zhillimin e teknologjisë në vend. Kredia "Shqipëria në moshën e internetit" mundëson blerjen e kompjuterave dhe pajisjeve të tjera elektronike nëpërmjet kësteve mujore, dhe njëkohësisht promovon aksesin falas në internet pranë Zyrave Postare.

Pa diskutim që rezultatet pozitive të vitit 2010 dhe sigurisht firmosja e një marrëveshje të tillë, janë tregues të objektivave ambicioze dhe fuqisë së Credins Bank në shërbim të shoqërisë Shqiptare, për të ofruar më të mirën në çdo skaj të vendit.



MARRËVESHJA E NËNSHKRUAR MIDIS CREDINS BANK DHE BANKËS SË DETIT TË ZI PËR TREG

Në datë 23 Dhjetor 2010, është nënshkruar një marrëveshje midis Credins Bank dhe Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim. Objekti i kësaj marrëveshje është të mbështesë Credins Bank në financimin e klientëve të saj në Republikën e Shqipërisë të cilët eksportojnë dhe importojnë mallra në adresë të Vendeve Anëtare ose jo-Anëtare.

Shuma që do të kanalizohet përmes Credins Bank do të jetë në vlerë totale 6.2 milion USD dhe do të disbursohet në 3 transhe brenda vitit 2011.

Marrëveshja e firmosur me Credins Bank është e para që Banka e Detit të Zi nënshkruan me një bankë nga Shqipëria. Kjo marrëveshje shënon fillimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve dhe ka për qëllim financimin e eksporteve dhe importeve mes vendeve anëtare të Bankës së Detit të Zi.

Banka e Detit të Zi është një institucion ndërkombëtar financiar i themeluar nga Shqipëria, Armenia, Azerbaixhani, Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia, Moldavia, Rumania, Rusia, Turqia, dhe Ukraina. Ajo përmes një kapitali të autorizuar prej 3 miliard SRD, mbështet zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin rajonal, duke siguruar tregtinë dhe financimin e projekteve, garancitë dhe kapitalin për projektet e zhvillimit në mbështetje të kompanive publike dhe private në vendet e saj anëtare.



objektivat për 2011

ZGJERIMI I RRJETIT TË DEGËVE

Në 2011 është planifikuar që të hapen 9 degë të reja duke rritur akoma më shumë përqendrimin e rrjetit të degëve në çdo qark të Shqipërisë. Zgjerimi i rrjetit të degëve ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet e Bankës për mbulimin me shërbime bankare të klientëve në të gjithë territorin.

ZGJERIMI I RETAIL BANKING

Zgjerimi i retail banking do të ndjekë të njëjtën linjë të ecurisë së Bankës duke e pasuruar atë me një gamë akoma më të gjerë produktesh dhe shërbimesh dhe me një segmentim gjithnjë e më të imët të klientelës. Për këtë qëllim, Banka këtë vit ka marrë përsipër të shtojë lehtësira bankare duke ofruar lloje të ndryshme kartash debiti e kreditit për nevoja dhe segmente të ndryshme të klientelës, duke shtuar mundësitë e investimit të fondeve jo vetëm në depozita por dhe në tregtimin e monedhave të çmuara dhe mbi të gjitha çmime konkurruese.

STRATEGJIA E SHTIMIT TË KLIENTËVE PAGATORË

Fokusi kryesor i të gjitha strukturave të Rrjetit të Degëve është drejtuar ndaj aktiviteteve të cilat gjenerojnë rritje të numrit të klientëve të rinj pagatorë dhe rritje të kënaqësisë së klientëve ekzistues. Për vitin 2011 objektivi ynë është që numri i pagatorëve të Bankës të rritet me të paktën 10.000 klientë duke e kthyer paketën PagaCredins në paketën më konkurruese në treg.

KARTAT, NUMRI I ATM-VE DHE TRANSAKSIONET NË ATM

Bazuar në të dhënat historike të vitit 2010, është parashikuar që numri i kartave dhe transaksioneve të rritet mesatarisht 35%. Rrjeti i ATM-ve Credins është parashikuar të zgjerohet me 13 ATM të reja. Një objektivi tjetër në lidhje me kartat VISA, është të zgjerojmë gamën e tyre me dy tipe të reja në treg të fokusuara sipas nevojave të segmenteve të ndryshme të tregut.

RRITJE

Aktivët

19.5%

Depozitat e klientëve

24.24%

Kredidhënia

23.15%

Kapitali aksionar

17.03%

Numri i klientëve

15%

Numri i punonjësve

600



adresat

ZYRA QENDRORE

Rruga Ismail Qemali, Nr 4, Tel. (04)22 34 096; 069 20 69666;
(04) 22 50 994; Fax. (04) 22 22 916; SWIFT Code: CDISALTR
www.bankacredins.com; info@bankacredins.com

DEGA TIRANA 2

Bulevardi "Zogu i I", Qendra VeVe. Tel. (04) 22 58 252; (04) 22 57 988; Fax. (04) 22 48 654.

DEGA TIRANA 3

Kryqëzimi 21-Dhjetorit. Tel. (04) 22 39 042. Fax. (04) 22 38 995

DEGA TIRANA 4

Rruga Komuna e Parisit, Tel. (04) 23 20 234, Fax. (04) 23 20 233

DEGA TIRANA 5

Rr. e Elbasanit, pranë "Shkollës së Baletit". Tel/Fax. (04) 23 47 809

DEGA TIRANA 6

Brenda Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Tel/Fax. (04) 23 76 305

DEGA TIRANA 7

Rruga Ali Demi, Tel/Fax. (04) 23 58 083

DEGA TIRANA 8

Rruga "Bardhyl", (tek kryqëzimi i Rr."Bardhyl" me Rr."Hoxha Tahsim"), Tel. (04) 23 47 572

DEGA TIRANA 9

Rruga Bajram Curri, pranë kryqëzimit të Shkollës së Bashkuar. Tel/Fax. (04) 23 47 560

DEGA TIRANA 10

Rr. "Ferrit Xhajko", (ish-Frigoferi). Tel. (04) 22 48 485

DEGA TIRANA 11

Rruga Gjini Bue Shpata, pranë stadiumit Selman Stermasi. Tel/Fax. (04) 22 56 694

DEGA TIRANA 12

Pranë Shkollës "Harry Fultz", Rr. Jordan Misja, Tel. (04) 22 35 439, Fax. (04) 22 30 756

DEGA TIRANA 13

Rr. Myslym Shyri, Tiranë. Tel. +355 4 24 21 223 Fax. +355 4 24 21 221

DEGA TIRANA 14

Rr. Don Bosko, Tiranë Tel. +355 4 240 6367 Fax. +355 4 240 6368

DEGA TIRANA 15

Rr. Luigj Gurakuqi, pranë Ushtarit të Panjohur, Tel: (04) 22 58 128, Fax: (04) 22 57 995

DEGA TIRANA 16

Bulevardi Gjergj Fishta, Tel/Fax: (04) 24 19 672

DEGA LAPRAKË

Tek Blloku "Gintash" (dykatëshet) në Laprakë, Tel : (04) 23 56789, Fax : (04) 23 56 285

DEGA VORË

Tel. (047) 26 00 435; Fax. (047) 26 00 422.

DEGA KAMËZ

Në qendër të Kamzës. Tel. (04) 22 00 485; Fax. (04) 22 00 487

AGJENCIA TIRANA 2

Autostrada Tiranë – Durrës, Km 11, pranë Emigres Sh.p.k. Tel/Fax. (048) 23 01 260

AGJENCIA TIRANA 3

Agjencia tek Hipoteka e Tiranës

DEGA DURRËS	Bulevardi kryesor, Rruga Tregtare, Nr 42. Tel. (052) 236 256, (052) 239 925; Fax. (052) 239 500.
AGJENCIA PORTI DURRËS	Tek sheshi i trageteve në Portin detar. Tel/Fax. (052) 234 500
AGJENCIA DURRËS 2	Pranë Qendrës Tregtare Industriale, Lagjja 17, Rr. Unazës, Tel/Fax. (052) 236 257
DEGA SHKOZET	Lagja 14, Përballë Shkollës së Mesme "Olsi Lasko", Shkozet, Durrës Tel. (052) 237 668; Fax. (052) 237 669
DEGA SHIJAK	Lagjja Kodër, Shijak. Tel. (0571) 23 069; Fax. (0571) 23 070
DEGA KAVAJË	Lagjja Nr. 5, Kavajë. Tel. (0554) 227 858; Fax. (0554) 227 859
DEGA FUSHË-KRUJË	Lagjja Kastrioti; Tel. (0563) 22 489; Fax. (0563) 22 490
DEGA FIER	Bulevardi "Jakov Xoxe". Tel. (034) 29 131; (034) 29 132; Fax. (034) 229 130
DEGA LEZHË	Lagjja Besëlidhja, Rruga "Luigj Gurakuqi" Nr 48. Tel. (0215) 23 500; Fax. (0215) 23 600
DEGA VLORA 1	Lagjja Pavarësia, Banesë 12 katëshe, Skelë, Vlorë. Tel. (033) 229 958; Fax. (033) 229 959
DEGA VLORA 2	Rr. "Demokracia", Lagjja. "Osmen Haxhiu", Vlorë. Tel. (033) 237 170
DEGA ELBASAN	Lagjja Aqif Pasha, Rruga 28 Nëntori, (pranë Drejtorisë së Policisë). Tel. (0544) 224 213; (0544) 24 472; Fax. (0544) 24204.
DEGA SHKODËR	Lagjja Vasil Shanto, Rruga "Vaso Kadia". Tel. (022) 250 643; (022) 250 645; Fax. (022) 250 633
DEGA KORÇË	Bulevardi "Republika", Lagja 12, (tek "Ish-Vetëshërbimi"). Tel. (082) 254 300; Fax. (082) 254 400
DEGA LUSHNJË	Bulevardi Kryesor, Ish-Hotel Myzeqeja Tel. (022) 2986; Fax. (022) 2983
DEGA KUKËS	Lagjja Nr.2 Pallati 67, Tel. (024) 224 903, Fax. (024) 224 904
DEGA BURREL	Lagjja Pjeter Budi, Burrel, Tel/ax: (02172) 3404, Fax: (02172) 3414
DEGA BALLSH	Lagjja "5 Shkurti", Ballsh, Tel: (0313) 23642, Fax: (0313) 23643
DEGA PESHKOPI	Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Tel: (0128) 25624, Fax: (0218) 25625
DEGA BERAT	Lagjja "22 Tetori", Shëtitorja kryesore, Tel: (0322) 34 612, Fax: (0322) 34718

bankat korrespondente

LEK

- Banka e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri LEK Acct. 2221059 L Code No. 212

EUR

- Deutsche Bank AG
Frankfurt Am Main, Frankfurt, Germany
Swift Code: DEUTDEFFXXX
EUR Acct. No. 100 921 2127 00
IBAN: DE90 5007 0010 0921 2127 00
- Standard Chartered Bank
Frankfurt Am Main, Frankfurt, Germany
Swift Code: SCBLDEFXXX
EUR Acct. No. 18122409
- Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG,
Vienna, Austria
Swift Code: RZBAATWWXXX
EUR Acct. No. 55.061.469
IBAN: AT563100000055061469
- Bank Austria Creditanstalt AG,
Vienna, Austria
Swift Code: BKAUATWWXXX
EUR Acct. No. 51010261001
- Intesa Sanpaolo SPA
Milano, Italy
Swift Code: BCITITMMXXX
EUR Acct. No. 9952195.01.21
- Banca Monte dei Paschi di Siena
Milano, Italy
Swift Code: PASCITMMXXX
EUR Acct. No. 560.50032.21
- Banca Popolare Dell' Emilia Romagna
Modena, Italy
Swift Code: BPMOIT22XXX
EUR Acct. No. 242031
- KBC BANK NV
Brussels, Belgium
Swift Code: KREDBEBBXXX
EUR Acct. No. 488-5917860-21
- NLB Prishtina D.D Prishtina, Kosova
EUR Acct. No. 1701002010004726
- BNP Paribas
Paris, France
IBAN: FR76 30004 00897 000 07000153 26
- Fortis Bank
Bruxelles, Belgium
Euro Acct. No. 291-1130900-74-Euro-0

- Banca Popolare di Milano SCaRL
Milano, Itali EUR Acct. No. 399/61137
- Bayerische Landesbank
Munich, Gjermani EUR Acct. No. 4210032

USD

- Standard Chartered Bank
New York, USA
Swift Code: SCBLUS33XXX USD Acct. No. 3582023443001
- Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG
Vienna, Austria
Swift Code: RZBAATWWXXX USD Acct. No. 70-55.061.469
- NLB PRISHTINA D.D, Prishtina, Kosova USD Acct. No. 1701002010004726
- Deutsche Bank AG
Frankfurt Am Main, Frankfurt, Germany
Swift Code: DEUTDEFFXXX USD Acct. No. 100 921 2127 00. USD
- Bank Trust Company Americas (DBTCA)
Frankfurt, Germany
Swift Code: BKTRUS33 USD Acct. No. 04-446-747

CHF

- Zuercher Kantonalbank,
Zurich, Switzerland
Swift Code: ZKBKCHZZXXX CHF Acct. No. 0700-00044296
- Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG
Vienna, Austria
Swift Code: RZBAATWWXXX CHF Acct. No. 73-55.061.469

GBP

- Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG
Vienna, Austria
Swift Code: RZBAATWWXXX GBP Acct. No. 83-55.061.469
- Deutsche Bank AG
Frankfurt Am Main, Frankfurt, Germany
Swift Code: DEUTDEFFXXX GBP Acct. No. 100 921 2127 00.GBP

CAD

- Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG
Vienna, Austria
Swift Code: RZBAATWWXXX CAD Acct. No. 71-55.061.469

pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(me raportin e auditorit të pavarur bashkëngjitur)





KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPT J91619001D

Telephone +355 4 2274 524
+355 4 2274 534
Telefax +355 4 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raport i Audituesit të Pavarur

Aksionerëve të
Banka Credins Sh.A.

Tiranë, 22 Prill 2011

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Banka Credins Sh.A. ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në datë 31 Dhjetor 2010, dhe pasqyrat e të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimet të kapitalit dhe të flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet shumat dhe informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të Bankës me datë 31 Dhjetor 2010, për rezultatet e saj financiare dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana
Albania

PASQYRA E TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE MË 31 DHJETOR 2010

(në Lek '000)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhura nga interesat	7	5,130,222	3,748,815
Shpenzime për interesa	7	<u>(2,435,130)</u>	<u>(1,884,454)</u>
Të ardhura neto nga interesat	7	2,695,092	1,864,361
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	8	315,882	288,200
Shpenzime për tarifat dhe komisionet	8	<u>(50,418)</u>	<u>(34,220)</u>
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	8	265,464	253,980
Shpenzime të tjera, neto		343	5,110
Fitim nga këmbimet valutore		<u>424,371</u>	<u>321,404</u>
Të ardhura të tjera nga aktivitetet bankare		424,714	326,514
Provizion për humbje nga kreditë	15	(1,222,660)	(625,256)
Amortizimi i aktiveve jo-materiale	18	(9,807)	(10,231)
Amortizim i ndërtesës dhe pajisjeve	17	(128,469)	(122,795)
Shpenzime personeli	9	(537,871)	(484,083)
Shpenzime administrative	10	<u>(739,472)</u>	<u>(612,682)</u>
		(2,638,279)	(1,855,047)
Fitimi para tatimit		746,991	589,808
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat	11	<u>(79,586)</u>	<u>(65,043)</u>
Fitimi për periudhën		667,405	524,765
Të ardhura përmblendhëse të tjera, neto nga tatimi mbi fitimin			
Rivlerësimi i aktiveve të vlefshme për shitje, neto nga tatimi mbi fitimin	16,19	25,236	55,199
Të ardhura përmblendhëse të tjera, neto nga tatimi mbi fitimin		25,236	55,199
Totali të ardhurave përmblendhëse për periudhën që i atribuohet aksionerëve		692,641	579,964

Shënimet në faqen 6 deri në faqen 46 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtoreve të Bankës Credins Sh.a. më 21 Prill 2011 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Artan Santo

Drejtor i Përgjithshëm



Valentina Prodani

Drejtoreshë e Financës dhe Kontabilitetit



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2010

(në Lek '000)

	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktivët			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	15,358,495	10,333,853
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	13	5,653,566	4,167,056
Hua dhe paradhënie bankave	14	676,868	236,023
Hua dhe paradhënie për klientët	15	40,258,141	30,242,343
Letra me vlerë të investuara	16	7,862,162	3,461,404
Ndërtesa dhe pajisje	17	786,486	760,511
Aktive jo-materiale	18	31,039	38,493
Aktive për tatime të shtyra	19	540	30,835
Tatimi aktual i aktiveve		46,807	53,337
Aktiv afatgjatë material i investuar	20	186,493	88,076
Aktive të tjera	21	<u>159,795</u>	<u>161,917</u>
Totali i aktiveve		<u>71,020,392</u>	<u>49,573,848</u>
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	22	1,847,413	1,007,826
Hua	23	134,427	124,651
Detyrime ndaj klientëve	24	62,165,614	43,235,026
Borxhi i varur	25	1,428,559	1,419,794
Detyrime të tjera	26	46,437	40,653
Provizionit	27	<u>11,086</u>	<u>14,673</u>
Totali i detyrimeve		65,633,536	45,842,623
Kapitali			
Kapitali aksioner	28	3,507,786	2,404,771
Primi i aksioneve		336,334	336,334
Rezerva e përgjithshme	29	797,679	412,940
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	16,19	77,652	52,415
Fitime të pa shpërndara		<u>667,405</u>	<u>524,765</u>
		5,386,856	3,731,225
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksioner		<u>71,020,392</u>	<u>49,573,848</u>

Shënimet nga faqja 6 deri në 46 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010

(në Lek '000)

	Kapitali aksioner	Primi i lidhur me aksionin	Rezerva e përgjithshme	Zëra të tjerë përmbledhëse	Rezerva rivlerësimi	Fitime të pa shpërndara	Totali i kapitalit
Gjendja më 1 Janar 2009	2,119,762	336,334	258,618	(299,605)	(2,784)	738,933	3, 151,258
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën							
Fitim i vitit aktual	-	-	-	-	-	524,765	524,765
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi mbi fitimin							
Rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	-	55,199	-	55,199
Totali të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	-	-	55,199	-	55,199
Totali të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën	-	-	-	-	55,199	524,765	579,964
Transaksione me pronarët, të regjistruara direkt në kapital							
Kontribute dhe shpërndarje nga pronarët	-	-	-	-	-	-	-
Përdorimi i fitimit të mbajtur	285,009	-	154,322	299,605	-	(738,933)	3
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes nga pronarët	285,009	-	154,322	299,605	-	(738,933)	3
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	2,404,771	336,334	412,940	-	52,415	524,765	3, 731,225

Shënimet nga faqja 6 deri në 46 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010 (VAZHDIM)

(në Lek '000)

	Kapitali aksioner	Primi i lidhur me aksionin	Rezerva e përgjithshme	Të ardhuratë tjera përmbledhëse	Rezerva rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Totali i kapitalit
Gjendja më 1 Janar 2010	2,404,771	336,334	412,940	-	52,415	524,765	3,731,225
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën							
Fitim i vitit aktual	-	-	-	-	-	667,405	667,405
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi mbi fitimin							
Rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	-	25,237	-	25,237
Totali të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	-	-	25,237	-	25,237
Totali të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën	-	-	-	-	25,237	667,405	667,405
Transaksione me pronarët, të regjistruara direkt në kapital							
Kontribute dhe shpërndarje nga aksionerët							
Përvetësimi i fitimeve të pa shpërndara	140,026	-	384,739	-	-	(524,765)	-
Rritje kapitali	962,990	-	-	-	-	-	962,990
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes nga aksionerët	1,103,016	-	384,739	-	-	(524,765)	962,990
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	3,507,786	336,334	797,679	-	77,652	667,405	5,386,856

Shënimet nga faqja 6 deri në 46 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Rrjedha e parasë nga operacionet			
Fitimi para tatimit		667,405	524,765
Rregullimet për:			
Amortizimi	17,18	138,276	133,026
Aktivitet fikse të nxjerra jashtë përdorimi	17,18	623	2,720
Çylerësimi i instrumentave financiarë	15	1,222,660	625,256
Hua të pakësuara në vlerë	15	(314,876)	(985)
Të ardhura nga interesat, neto	7	(2,695,092)	(1,864,361)
Shpenzime e tatimit mbi të ardhurat	11	79,586	65,043
Efekti i kursit të këmbimit në borxhin e varur		6,672	144,824
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave		(437,254)	509,768
Ndryshimi në hua dhe paradhënie klientëve		(10,124,322)	(6,455,672)
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me BoA		(1,486,151)	(916,766)
Ndryshim në investime në pasuri të patundshme		(98,417)	(31,421)
Ndryshimi në aktive të tjera		2,122	35,130
Ndryshim në detyrimet ndaj bankave		818,995	(109,073)
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve		18,642,944	8,662,793
Ndryshimi në detyrime të tjera		2,197	29,667
Interesi i arkëtuar		4,242,572	3,573,380
Interesi i paguar		(2,115,026)	(1,884,454)
Tatim fitimi i paguar		<u>(42,761)</u>	<u>(96,417)</u>
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		8,510,153	2,947,223
Flukset monetare nga aktivitetet investuese:			
Shitj/(blerje) e letrave me vlerë		(4,291,081)	688,824
Blerje e ndërtesave dhe pajisjeve	17	(155,067)	(110,391)
Blerje e aktiveve jo-materiale	18	<u>(2,353)</u>	<u>(13,587)</u>
Flukset monetare neto në aktivitetet investuese		(4,448,501)	564,846
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Kapitali i nënshkruar		<u>962,990</u>	-
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese		962,990	-
Rritje neto në aktive monetare dhe ekuivalente me to		5,024,642	3,512,069
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 1 Janar		10,333,853	6,821,784
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor	12	<u>15,358,495</u>	<u>10,333,853</u>

Shënimet nga faqja 6 deri në 46 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

1. NJËSIA RAPORTUESE

Banka Credins Sh.a. (që në vazhdim, do t'i referohemi si "Banka") është një institucion financiar i themeluar më 1 Prill 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 Mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", miratuar në Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në Dhjetor 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë".

Me 31 Dhjetor 2010, Banka ushtronte aktivitetin e saj nepermjet drejtorise se pergjithshme ne Tirane dhe 41 degeve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër Korçë, Shijak, Shkzet, Kavajë, Lushnje, Fushë Krujë, Kukës, Burrel, Ballsh, Berat, dhe Peshkopi si dhe 4 agjensive në Tiranë dhe Portin e Durrësit. Më 31 Dhjetor 2010 Banka kishte 516 punonjës (31 Dhjetor 2009: 447 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç si me poshte:

- aktiveve financiare të vlefshme për shitje të matura me vlerë të drejtë
- aktiveve afatgjata materiale të investuara të matura me vlerë të drejtë

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacione mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël të njohura në pasqyrat financiare paraqiten në shënimet 6, 15, 16 dhe 19.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivet jo monetare dhe detyrimet maten në kosto historike të monedhave të huaja dhe këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lek ndaj një njësie të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
USD	104.00	95.81
EUR	138.77	137.96
GBP	161.46	154.64
CHF	110.98	93.04
CAD	104.29	91.34
XAU	4,715.77	3,398.26

b) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një mjeti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të në fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

c) Tarifat dhe Komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifatat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifatat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për tarifatat dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

d) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra nën qiratë e zakonshme janë njohur në fitim ose humbje me metodën lineare mbi afatet e qirasë. Iniciativat për qiratë të ndërmarra janë njohur si një pjesë integrale e totalit të shpenzimit mbi afatet e qirasë financiare.

e) Shpenzimi i tatim mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zërat e kapitalit e cila njihet direkt në kapital ose në të ardhurat përmbledhëse të tjera.

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo rregullim për taksat e pagueshme nga vitet e mëparshme. E ardhura e tatueshme llogaritet duke korrigjuar fitimin sipas raportimit për qëllime ligjore para tatimeve për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga ligji shqiptar.

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit të cilat pritët të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë bazuar në ligjet të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Aktivet për tatimet e shtyra njihen në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të përdoren, ndaj të cilave ato mund të mundësohen. Aktivët për tatimet e shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe ulen në atë masë që nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

f) Aktivët dhe detyrimet financiare

i) Njohja

Banka fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet, depozitat, instrumentat e borxhit dhe borxhin e varur në datën e krijimit. Mënyrat e rregullta të blerjes dhe shitjes së aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka kryen blerjen ose shitjen e aktiveve. Të gjithë aktivët dhe detyrimet financiare (duke përfshirë aktivët dhe detyrimet të dizenuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) fillimisht njihen në datën kur Banka bëhet palë kontraktuale e një instrumenti.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit.

ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabël 3 (g), (h), (i) and (n)

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

f. Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

iii) Çregjistrimi (Mosnjohja)

Aktivitetet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Bankës ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Banka i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka çregjistrohen detyrimet financiare nëse detyrimet kontraktuale të saj përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin e transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin, për shembull huadhënien dhe riblerjen e letrave me vlerë.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi "swap" për aktivet e transferuar, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financues i sigurt i njëjtë me riblerjen e transaksionit. Transaksionet, në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqe dhe përfitimet e lidhur me aktivin financiar, e çregjistrojnë aktivin nëse humbet kontrollin mbi të. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim njihen të ndara si aktive dhe detyrime. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Banka vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në disa transaksione, Banka mban të drejtat për të marrë ose kryen shërbime për një aktiv financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet tërësisht në qoftë se ai i përmbush kriteret e çregjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat për shërbimin, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

Banka pakëson vlerën e disa kredive kur ato janë përcaktuar si të paarkëtueshme (shiko shënimin 3.f.vii).

iv) Netimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt çvlerësimi.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

vi) Matja me Vlerë të Drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyehet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën që kanë njohuri dhe mundësi të kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Kur është e mundshme, Banka e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksione të tregut aktuale dhe në mënyrë të rregullt. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën që kanë njohurinë dhe mundësinë (nëse është e disponueshme), referencë tek vlera e drejtë aktuale e instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara dhe modelet e vlerësimit të opsioneve. Teknika e zgjedhur e vlerësimit bazohet maksimalisht te të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në llogaritjet specifike të Bankës, bashkon të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg konsiderojnë në vendosjen e çmimit dhe është konsistente me metodologjitë ekonomike të pranura për vendosjen e çmimit për instrumentat financiarë. Të dhënat për teknikat e vlerësimit paraqesin pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë. Banka kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg.

Evidence më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e dhënë ose e marrë vetëm nëse vlera e drejtë e atij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për instrumenta të njëjtë (p.sh., pa modifikime ose repaketim) ose e bazuar në metodat e vlerësimit në të cilat variablat përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përftuar nga një model vlerësimi është njohur më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të mbyllet.

Aktivitet dhe pozicionimet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionimet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Banka ka një pozicionim me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, çmime mid-market janë përdorur për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuar dhe një çmim i kërkuar ose ofertë rregullimi është aplikuar vetëm tek pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin rregullime të cilat marrin parasysh rrezikun e kreditimit të Bankës dhe të palës tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përftuara nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do të merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

vii) Identifikimi dhe matja e çvlerësimit

Në çdo datë bilanci Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë çvlerësuar. Aktivet financiare çvlerësohen kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka konsideron mundësinë e çvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për çvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk çvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuara) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare (duke përfshirë letrat me vlerë të kapitalit neto) të çvlerësuar mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Banka me kusht që Banka nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Për trajtimin e çvlerësimit në grup Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

Humbjet nga çvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuara llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari fondi për humbjet nga çvlerësimi përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e çvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimit.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit shkakton uljen e humbjes nga çvlerësimi, kjo ulje reflektohet në fitim ose humbje.

Humbjet nga çvlerësimi për letrat me vlerë të investuara të gatshme për shitje njihen duke transferuar humbjen kumulative e cila është njohur në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse në fitim ose humbje si rregullim i riklasifikuar. Humbja kumulative e cila është riklasifikuar nga të ardhura të tjera përmbledhëse në fitim ose humbje është diferenca midis kostos së blerjes, neto nga ripagesa principali dhe amortizimit, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga çvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provizionin e çvlerësimit që i atribuohen vlerës në kohë reflektohen si komponentë të të ardhurave nga interesi.

Nëse, në një periudhë të mëpasshme, vlera e drejtë e çvlerësimit i instrumentave të borxhit të gatshme për shitje rritet dhe rritja lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje e cila ka ndodhur pasi humbja nga çvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga çvlerësimi anulohet me shumën e njohur në fitim ose humbje. Megjithatë çdo rikuperim i mëpasshëm i vlerës së drejtë të çvlerësimit të instrumentave të borxhit të gatshme për shitje njihet në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet monetare dhe ekuivalente me to

Aktivët monetarë dhe ekuivalentët me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, balanca të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt të rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Aktivët monetarë dhe ekuivalentët me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e të pozicionit financiar.

h) Huatë dhe paradhënie klienteve

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim ti shesë në një periudhë afatshkurtër.

Kur Banka është qiradhënësi në një kontratë qiraje, ku transferohen në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mjetit, marrëveshja paraqitet brenda huave dhe paradhënieve.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes ose huadhënie të siguruara nga letra me vlerë), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

i) Investime në letra me vlerë

Letrat me vlerë të investuara fillimisht njihen me vlerën e drejtë plus kosto transaksioni direkte shtesë dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë në fitim ose humbje ose të gatshme për shitje.

(i) Të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk janë dizenuar me vlerë të drejtë në fitim ose humbje ose të vlefshme për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të rëndësishme të investimeve të mbajtura deri në maturim jo të mbyllura në maturim do të riklasifikohen si investime të mbajtura deri në maturim të gatshme për shitje dhe do të do të përjashtojnë Bankën nga klasifikimi i investimeve të mbajtura deri në maturim për periudhën financiare aktuale dhe deri në dy vjet.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

i) Letra me vlerë të investuara (vazhdim)

(i) Investime të vlefshme për shitje

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative dhe nuk dizajnohen në një kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuar vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme mbarten me kosto. Të gjithë investimet e vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur normën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit nga investimet e borxhit të vlefshme për shitje njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera përmbledhëse deri kur investimi është shitur ose çvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar njihet në fitim ose humbje.

i) Ndërtesa dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Ndërtesa dhe pajisje maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga çvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë-përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë e rëndësishme e pajisjes funksional kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që përfitime të ardhshme ekonomike do të vijnë për Bankën dhe kostot e tij mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës zbritëse mbijetën e dobishme të vlerësuar të aktivit përveçse për aktivet që çvlerësohen me metodën lineare. Aktivet e marra me qira çvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk çvlerësohet. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Ndërtesa	5%
Pajisje elektronike dhe zyre	20%
Automjete	20%
Mobilje dhe pajisje të tjera	20%
Investime në mjetet marrë me qera	5%-20%

Metoda e çvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

k) Aktivet jo-materiale

(i) Programe kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimit njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është pesë vjet.

(ii) Licencat

Licencat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Banka janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga çvlerësimi nëse ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare mbi jetën e dobishme të licencës që nga data që është e vlefshme për përdorim. Jeta e dobishme e licencave është 10 vjet.

l) Aktivet me qira

Qira të tjera janë qira të zakonshme dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës.

m) Çvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të bankës, përveç aktiveve për tatime të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për çvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga çvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivit e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësise gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka çvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga çvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga çvlerësimi.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

n) Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxh i varur janë burimet kryesore të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një “marrëveshje ri-blerjeje” ose “huadhënie të garantuar” për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxh i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Banka zgjedh që ti mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje.

o) Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

Një provizion për ristrukturime njihet kur Banka ka aprovuar një plan formal dhe të detajuar ristrukturimi dhe ristrukturimi ka filluar ose është bërë publik. Kostot operacionale të ardhshme nuk mbulohen.

Provizioni për kontratat “onerous” njihet kur përfitimet e pritura që rrjedhin në Bankë nga një kontratë janë më të vogla sesa kostot e pashmangshme të përmblotjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Provizionin matet me vlerën aktuale e më të vogël midis kostos së pritur të mbarimit të kontratës dhe kostos së pritur neto të vazhdimit të kontratës. Para sesa ky provizion të vendoset, Banka njeh çdo humbje nga çvlerësimi i aktivitetit që lidhet me kontratën në fjalë.

p) Garancitë Financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

q) Përfitimet e punonjësve

(i) Plani i pensionit me kontribute te percaktuara

Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Banka njih si detyrime shumë të përlogaritur të kostos që pritët të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

r) Netimi i operacioneve në monedhë të huaj

Kontratat në monedhë të huaj janë marrëveshje për të shkëmbyer shuma specifike të monedhave në një kurs këmbimi specifik “të çastit” ose “të ardhshëm”. Shuma nominale e këtyre kontratave nuk paraqet rrezikun aktual të tregut ose kreditimit të lidhur me këtë produkt.

s) Aktive afatgjata materiale te investuara

Aktivitet afatgjata të investuara janë prona të mbajtura ose për të gjeneruar të ardhura nga qiraja ose për të vlerësuar kapitalin ose për të dyja arsyet, por jo për tu shitur në aktivitetin normal të biznesit, për tu përdorur në ofrimin e shërbimeve ose për arsye administrative. Banka ka disa aktive afatgjata te investuara të cilat i ka marrë nga ekzekutimi i kolateraleve të huave ndaj klienteve. Aktivitet afatgjata të investuara maten me kosto në njohjen fillestare dhe më pas me vlerën e drejtë dhe cdo ndryshim njihet në pasqyrën e humbje fitimeve në zerin e të ardhurave të tjera.

t) Standarte dhe interpretime të reja të pa adoptuara ende

Një numër standardesh të reja, amendime apo interpretime të tyre ende nuk janë bërë efektive për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2010, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk do të ketë efekt në pasqyrat financiare të Bankës.

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a) Një vështrim i përgjithëm

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe manaxhimin e rrezikut, dhe manaxhimin e kapitalit të Bankës.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Bankës, e atë Operacional, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në fushat e tyre specifike për të paravendosur limitet e ekspozimit.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Banka, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i Kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Bankës për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare i Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vet klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Rreziku që rrjedh nga tregtimi i letrave me vlerë mbahet në nivele të ulëta sepse përbëhet vetëm nga letra me vlerë shtetërore, Bono dhe obligacione thesari që janë konsideruar si instrumenta pa rrezik.

Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kreditimit të Bankës për ekspozimet e rrezikut më të mëdha sesa 10% e kapitalit rregullues. Bordi i drejtorëve në bashkëpunim me Komitetin e Kredisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kreditit të Bankës duke përfshirë:

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut, dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.

Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve. Limitet e aprovimit i janë shpërndarë Komitetit të Kreditimit dhe Drejtuesit të Departamentit të Korporatave, SME-ve dhe Kreditimit Individual respektivisht. Për shuma më të mëdha kërkohet aprovimi i Komitetit të Kreditimit ose i Bordit të Drejtorëve si të gjykohet më e përshtatshme.

Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë. Komiteti i Kreditimit vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kredisë të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces.

Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit ndaj palëve të tjera, industrive të ndryshme, monedhave dhe maturitetit.

Zhvillimin dhe përdormin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për çvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kredisë. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston prej pesë kategorish në përputhje me rregulloren e "Administrimit të Rrezikut të Kredisë" të Bankës së Shqipërisë të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe vlefshmërinë e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kredisë. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut i takon Komitetit të Kredisë dhe janë subjekt i monitorimit mujor.

Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industritë e zgjedhura, rrezikut të shtetit dhe llojeve të produkteve. Komiteti i Kreditimit të Bankës merr dhe shqyrton rregullisht raporte mbi cilësinë e kreditimit dhe ndërmerr veprime përkatëse korrigjuese.

Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njërive të biznesit për të zhvilluar praktikatat më të mira për administrimin e rrezikut të kredisë në të gjithë Bankën.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikat dhe procedurat e Bankës për administrimin e rrezikut të kredisë autorizuar nga Komiteti i Kreditimit. Çdo njësi biznesi/degë ka një shef për rrezikun e kredisë i cili raporton për të gjitha çështjet lidhur me rrezikun e kredisë tek administrimi lokal i Bankës dhe tek Komiteti i Kreditit të Bankës. Çdo njësi biznesi/degë është përgjegjës për cilësinë dhe performancën e portofolit të tij të kredive duke përfshirë edhe ato me aprovimin nga qendra.

Kontrolle të rregullta të njërive të biznesit dhe të proceseve të kreditimit të Bankës ndërmerren nga Kontrolli i Brendshëm.

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
<i>Hua dhe paradhënie klientëve</i>		
Të çylerësuar individualisht		
Standarde	1,659,455	2,074,837
Në ndjekje	566,744	944,411
Nën standarde	619,700	945,688
E dyshimtë	963,245	318,132
E humbur	<u>496,228</u>	<u>128,768</u>
<i>Vlera bruto</i>	4,305,372	4,411,836
Zbritje nga çylerësimi	<u>(1,225,875)</u>	<u>(757,017)</u>
<i>Vlera neto</i>	3,079,497	3,654,819
<i>Të çylerësuar në grup</i>		
Standarde	32,987,366	23,043,377
Në ndjekje	2,672,526	2,283,314
Nën standarde	1,359,980	1,232,723
E dyshimtë	744,142	313,846
E humbur	<u>410,000</u>	<u>170,663</u>
<i>Vlera bruto</i>	38,174,014	27,043,923
Zbritje nga çylerësimi	<u>(995,370)</u>	<u>(456,399)</u>
<i>Vlera neto</i>	37,178,644	26,587,524
Totali i vlerës neto	40,258,141	30,242,343
 <i>Hua dhënë bankave</i>		
<i>As me vonesë e as të çylerësuar</i>		
Standarde	676,868	236,023
Totali i vlerës neto	676,868	236,023
 <i>Investime në instrumenta financiarë</i>		
<i>As me vonesë ose të çylerësuar</i>		
Standarde	<u>7,862,162</u>	<u>3,461,404</u>
Totali i vlerës neto	7,862,162	3,461,404

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Hua dhe letra me vlerë të çvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë të çvlerësuar janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të huasë në bazë të kushteve të kontratës.

Fondi për humbje nga çvlerësimi

Banka krijon një fond për humbjet nga çvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Bankës për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provizioni janë, një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme, dhe një provizion të përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për çvlerësime.

Politika e pakësimit të vlerës

Pakësimi i vlerës së humbjeve bëhet me vendim nga Bordi i Drejtorëve kur procesi ligjor për ripagimin e kredisë ka përfunduar dhe klienti vazhdon të mbetet debitor për pjesën e papaguar të huasë.

Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e fondit për çvlerësim) të aktiveve individualisht të çvlerësuar, sipas shkallës së rrezikut.

	Hua dhe parapagime dhënë klientëve	
	Bruto	Neto
31 Dhjetor 2010		
Standarde: Të çvlerësuar individualisht	1,659,455	1,265,563
Në ndjekje: Të çvlerësuar individualisht	566,744	492,705
Nën standarde: Të çvlerësuar individualisht	619,700	262,610
E dyshimtë: Të çvlerësuar individualisht	963,245	729,028
E humbur: Të çvlerësuar individualisht	<u>496,228</u>	<u>329,591</u>
Totali	4,305,372	3,079,497
31 Dhjetor 2009		
Standarde: Të çvlerësuar individualisht	2,074,837	1,662,740
Në ndjekje: Të çvlerësuar individualisht	944,411	819,573
Nën standarde: Të çvlerësuar individualisht	945,688	808,455
E dyshimtë: Të çvlerësuar individualisht	318,132	242,687
E humbur: Të çvlerësuar individualisht	<u>128,768</u>	<u>121,364</u>
Totali	4,411,836	3,654,819

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Banka mban kolateral ndaj kredive dhe paradhënieve të klientëve në formën pengut të pasurisë, siguri të tjera të regjistruara ndaj aktiveve dhe garanci. Llogaritjet e vlerës së drejtë të kolateralit të vlerësuar në kohën e huasë zakonisht nuk janë freskuar përveç rastit kur një kredi është vlerësuar si e çvlerësuar. Zakonisht nuk mbahet kolateral mbi kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave. Kolateral nuk mbahet ndaj investimeve në instrumentat financiare dhe nuk është mbajtur ndonjë kolateral i tillë për fundvitin e 31 Dhjetor 2010 ose 2009.

Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe letrave me vlerë të tjera të mbajtura ndaj aktiveve financiare është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Ndaj huave individualisht të çvlerësuar		
Prona	3,965,971	4,905,703
Të tjera	1,712,520	1,715,947
Ndaj huave i të çvlerësuar në grup		
Prona	64,937,899	82,202,612
Të tjera	<u>39,794,956</u>	<u>31,989,785</u>
Total	110,411,346	120,814,047

Banka monitoron rrezikun e përqëndrimit të kredisë sipas sektorëve, sipas maturitetit dhe sipas monedhës. Një analizë e përqëndrimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është si më poshtë:

Hua dhe paradhënie dhënë klientëve (bruto)	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Ndërtim	9,501,319	6,118,690
Tregti	13,371,328	8,099,966
Kredi konsumatore	2,904,587	2,868,807
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale	3,295,293	3,050,755
Industria perpunuese	1,212,019	2,375,041
Hotele dhe restorante	1,224,244	1,317,073
Prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike etj.	3,940,649	2,331,301
Pasuri e patundshme	3,683,633	3,340,284
Transport dhe komunikim	1,205,516	370,515
Aktivitetet financiare	192,985	241,230
Agrikulture	102,900	151,541
Industri punime minerale	359,905	32,176
Aktivitet social dhe shëndetësor	235,164	386,625
Të tjera	<u>1,249,843</u>	<u>771,756</u>
Totali	42,479,386	31,455,760

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të përmbushë pagesën e angazhimeve që lindin nga detyrimet financiare.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i Bankës në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj.

Likuiditeti afat-shkurtër administrohet nga Departamenti i Thesarit, ndërsa likuiditeti afat-mesëm dhe afat-gjatë administrohet nga ALCO. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut raporton në mënyrë periodike tek ALCO dhe Departamenti i Thesarit mbi ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.

Departamenti i Thesarit mban një portofol aktivesh me likuiditet afat-shkurtër, përbërë nga letra me vlera me maturim afatshkurtër, hua dhe paradhënie ndaj bankave të tjera dhe facilitete të tjera ndërbankare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm likuiditeti të Bankës.

Raportet ditore të Thesarit si edhe ato javore e mujore të Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut mbulojnë pozicionin e likuiditetit të Bankës. Të gjitha politikat dhe procedurat janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga ALCO.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Mënyrat kryesore të përdorura nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit janë raportet e likuiditetit dhe vlerësimi i hendekut për periudha specifike.

Volatiliteti në tregjet financiare globale dhe shqiptare

Vazhdimi i krizës financiare dhe ekonomike botërore ka ndikim midis të tjerash edhe mbi zvogëlimin e tregjeve kapitale, uljen e likuiditetit në sistemin bankar dhe, në momente specifike, edhe në rritjen e interesit të kreditimit ndërbankar dhe volatilitetin e tregjet të letrave me vlerë. Zhvillime të tjera jo të favorshme të krizës mund të ndikojnë negativisht mbi pozicionin financiar dhe likuiditetin e Bankës.

Banka përlogarit mbi baza javore këto raporte: raportin e aktiveve likuide mbi detyrimet afat-shkurtra, huatë ndaj depozitave dhe aktivet likuide ndaj depositave. Aktivet likuide përfshijnë paranë dhe ekuivalentet e saj, bonot e thesarit të qeverisë shqiptare dhe çdo depozitë afat-shkurtër në bankat e tjera me maturitet deri në një muaj. Detaje të raporteve të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afat-shkurtra janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Mesatarja për periudhën	163.39%	132.33%
Minimumi për periudhën	135.70%	102.95%
Maksimumi për periudhën	197.25%	170.75%

Hendeku i maturitetit për monedhat kryesore përlogaritet dhe analizohet nga Banka mbi baza një mujore. Tabela e mëposhtme tregon një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës më 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 mbi bazën e maturitetit të mbetur:

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare

31 Dhjetor 2010	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Aktivët financiarë							
Aktive monetare dhe ekuivalente	13,037,569	2,320,926	-	-	-	-	15,358,495
Shuma të kushtëzuara me BQ	1,097,022	1,246,000	1,063,839	2,014,299	232,406	-	5,653,566
Hua dhënë bankave	280,913	-	312,464	83,491	-	-	676,868
Investime në instrumenta financiarë	50,440	1,162,704	1,181,235	2,863,313	2,604,470	-	7,862,162
Hua dhe paradhënie për klientët	2,313,412	5,418,336	3,942,547	4,992,716	18,310,748	5,280,382	40,258,141
Aktive afatgjata materiale të invest.	-	-	-	-	186,493	-	186,493
Aktive të tjera	<u>145,421</u>	<u>61,181</u>	-	-	-	-	<u>206,602</u>
Totali	<u>16,924,776</u>	<u>10,209,147</u>	<u>6,500,085</u>	<u>9,953,819</u>	<u>21,334,117</u>	<u>5,280,382</u>	<u>70,202,327</u>
Detyrime financiare							
Detyrime ndaj bankave	465,422	164,656	182,727	412,522	622,086	-	1,847,413
Hua	-	69,994	-	62,447	1,986	-	134,427
Detyrime ndaj klientëve	13,415,645	12,306,949	11,107,786	22,634,817	2,692,934	7,483	62,165,614
Borxhi i varur	-	24,206	-	-	381,156	1,023,197	1,428,559
Detyrime të tjera	<u>46,437</u>	-	-	-	-	-	<u>46,437</u>
Totali	<u>13,927,504</u>	<u>12,565,805</u>	<u>11,290,513</u>	<u>23,109,786</u>	<u>3,698,162</u>	<u>1,030,680</u>	<u>65,622,450</u>
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2010	<u>2,997,273</u>	<u>(2,356,658)</u>	<u>(4,790,428)</u>	<u>(13,155,967)</u>	<u>17,635,955</u>	<u>4,249,702</u>	<u>4,579,877</u>
Kumulativi	<u>2,997,273</u>	<u>640,615</u>	<u>(4,149,813)</u>	<u>(17,305,780)</u>	<u>330,175</u>	<u>4,579,877</u>	-
31 Dhjetor 2009							
Totali i aktiveve financiare	<u>15,106,855</u>	<u>4,776,718</u>	<u>3,581,547</u>	<u>5,835,247</u>	<u>14,625,415</u>	<u>4,818,227</u>	<u>48,744,009</u>
Totali i detyrimeve financiare	<u>9,072,553</u>	<u>8,713,167</u>	<u>8,050,357</u>	<u>15,608,474</u>	<u>4,376,499</u>	<u>6,900</u>	<u>45,827,950</u>
Rreziku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2009	<u>6,034,302</u>	<u>(3,936,449)</u>	<u>(4,468,810)</u>	<u>(9,773,227)</u>	<u>10,248,916</u>	<u>4,811,327</u>	<u>2,916,059</u>
Kumulative	<u>6,034,302</u>	<u>2,097,853</u>	<u>(2,370,957)</u>	<u>(12,144,184)</u>	<u>(1,895,268)</u>	<u>2,916,059</u>	-

4. ADMINSTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit do të ndikojë në të ardhurat e Bankës apo vlerën e instrumentave financiarë.

Administrimi i rrezikut të tregut

ALCO është përgjegjëse për administrimin e gjithë rrezikut të tregut. Rreziku i kursit të këmbimit përllogaritet dhe raportohet nga Departamenti i Administrimit të Rrezikut mbi baza ditore. Banka e administron rrezikun duke mbyllur pozicionet e hapura si dhe duke vendosur dhe monitoruar limite mbi pozicionet e hapura. Banka administron rrezikun e normave të interesit duke përdorur analizën e rëqimit të hendekut dhe analizën e marzhit të fitimit për secilën nga monedhat kryesore. Departamenti i Administrimit të Rrezikut i përpilon këto raporte mbi baza mujore.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve më 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 sipas monedhes origjinale është si me poshte:

	ALL	USD	EUR	Të tjera	Totali
Aktivët					
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	2,747,401	4,223,145	7,864,697	523,252	15,358,495
